



MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIFËRMARRJES  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

## URDHËR

Nr ~~9627~~ / 11 Datë 22 / 12 / 2015

### PËR

#### PRISHJEN E SHOQËRISË “ ALBMINIERA ” SH.A, TIRANË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 1 të Ligjit Nr. 8885, datë 22.4.2002, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.4.1995 “ Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me akte të tjera ligjore, dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “ Albminiera” sha Tiranë,

#### URDHËROJ:

1. Prishjen e shoqërisë “ Albminiera” sha Tiranë, dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Z. Petraq Premti, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
4. Z. Elton Mersini, Ekspert Kontabël i Autorizuar, të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE  
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT ✓

185  
20.11.17

17.11.17

166/2

URDHËR

Nr. 140 Datë 17.11.17

PËR  
LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË LIKUIDATORIT TË SHOQËRISË  
“ALBMINIERA” SH.A. NË LIKUIDIM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 8237, datë 01.09.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar dhe nenit 191, të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me cilësinë e aksionarit të vetëm,

URDHËROJ :

1. Lirimnin nga detyra të Likuidatorit të shoqërisë “Albminiera” sh.a. në likuidim  
Z. Petraq Premti.
2. Ndërprerja e marrëdhënieve financiare të bëhet bazuar në legjislacionin në fuqi.
3. Emërimin në detyrë të Likuidatorit të shoqërisë “Albminiera” sh.a. në likuidim  
Z. Vasil Dilo.
4. Marrëdhëniet financiare fillojnë me marrjen e detyrës.

Ngarkohet shoqëria “Albminiera” sh.a. në likuidim, për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

*Njësuar me origjinalin*  
*S. Arben Ahmetaj*

